

Ekskluzive

Ekskluzive | Informacioni çon Policinë në shtëpinë e 47-vjeçarit në Gjakovë – dorëzon tri armë, karikatorë e municion



Sinjali.com

21 Gusht 2026 09:19



Një informacion i pranuar nga hetuesit se një person në Gjakovë posedonte armë pa leje ka çuar Policinë në shtëpinë e tij, ku janë sekuestruar tri armë, karikatorë dhe municion, mëson Sinjali.

Rasti është zhvilluar mbrëmjen e 20 gushtit, rreth orës 19:45, në rrugën “Hamez Zymeri” në Gjakovë.

Sipas informacioneve që ka siguruar Sinjali, personi i dyshuar është **Kujtim Hasi** 47-vjeçar.

Pas informacionit të pranuar, patrulla policore dhe Njësia e Hetimeve kanë shkuar bashkë me të dyshuarin në shtëpinë e tij.

Hasi ka bashkëpunuar me zyrtarët policorë dhe i ka dorëzuar vullnetarisht armët që posedonte.

Policia ka sekuestruar një armë të gjatë të tipit “shotgun”, dy pistoleta – njëra prej tyre “Zastava” – si dhe tre karikatorë, dy për pistoletë TT dhe një për “Zastava”.

Bashkë me armët janë sekuestruar edhe gjashtë fishekë të kalibrit 12GA dhe pesë fishekë të kalibrit 6.35 mm.

Të gjitha armët, karikatorët dhe municioni janë marrë si prova materiale dhe do të trajtohen në kuadër të procedurës hetimore.

Për rastin është njoftuar Prokurori kujdestar, me udhëzim të të cilit është iniciuar rasti për “Mbajtje në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”.

Pas përfundimit të procedurave fillestare, 47-vjeçari është liruar në procedurë të rregullt, ndërsa rasti mbetet nën hetime.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera